



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.45/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Delushe Halimi dhe Ragip Namani anëtarë, në çështjen juridike të dënuarit B. M., i lindur me datë, në P., ku edhe e ka vendbanimin në "....", nr....., përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr....., të datës 28.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 02.12.2024, merr këtë:

AKTVENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të dënuarit B. M. nga i ati F. dhe e ëma Sh., e gjinisë K., i lindur me datë, në Pejë, ku edhe e ka vendbanimin në "...", nr., me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr....., të datës 28.10.2024, në pikën I të dispozitivit " Refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit B. M. nga i ati F. dhe e ëma Sh., e gjinisë K., i lindur me datë, në P., ku edhe e ka vendbanimin në..... "....", nr., me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. II. Kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej tre (3) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

I dënuari me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të gabimeve faktike siç thuhet në ankesë, sepse nuk janë marrë parasysh faktet e gjendjes sociale, ekonomike dhe familjare me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoj aktvendimin e atakuar të Panelit për Lirim me Kusht ashtu që të aprovoj kërkesën e të dënuarit dhe të liroj nga vuajtja e dënimit në atë mënyrë që do t'ia kushtëztoj pjesën e mbetur të dënimit ta kryej në shtëpi në pajtim me ligjin.

Paneli për Lirim me Kusht, në përgjigje në ankesën, e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e të dënuarit, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa, ndërsa vendimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit nr. 08/L-132, për Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, vendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me datë 09.10.2024, i dënuari përmes Institucionit Korrektues ku është në mbajtje të dënimit me burg, ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht me arsyetimin se gjatë mbajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Në seancën e mbajtur me 28.10.2024, Paneli pasi e shqyrtoi dosjen e të dënuarit, përkatësisht raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Institucionit Korrektues, Deklaratë- premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenin 15 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.

Nga shkresat e dosjes së të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprave penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së dhe mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par. I të KPRK-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se data e përfundimit të dënimit është caktuar më 12.03.2025 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se të dënuarit i kanë mbetur edhe 4 muaj, 14 ditë. Në raportet e tjera të përpiluara nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, rezulton se i dënuari ka treguar sjellje të mirë. Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese ka konstatuar të lartë rrezikshmërinë për recidivizëm dhe ndaj komunitetit. Në të dhënat për realizimin e programit për trajtimin e të dënuarit, është konstatuar se i dënuari është i angazhuar me punë dhe pjesërisht person bashkëpunues. Po ashtu, sipas ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, procesi i risocializimit ka arritur progres, por sipas ekipit nuk është përfunduar.

Gjatë shqyrtimit të dosjes së të dënuarit, Paneli vlerësoj plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në lirimin me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht. Rrethanat përfshijnë: përshkrimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore,

planet e të dënuarit pas lirimit, pranimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ShSK, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për shoqërinë/komunitetin, programet rehabilituese të ndjekura nga personi i dënuar, vlerësimin e progresit të arritur te i dënuari në planin individual të rehabilitimit dhe rrethanat e tjera të vlerësuara nga paneli që tregojnë se i njëjti nuk do të kryej veprë penale.

Paneli pas shqyrtimit të dosjes, vlerësimit të kushteve dhe rrethanave të caktuara në rregullore, konstaton se të dënuarit i duhet ende kohë për të mbajtur dënimin në mënyrë që të vlerësohet sjellja e të njëjtit. Kategorizimi se ekziston rrezikshmëria tregon një indikator që të dënuarit i duhet ende kohë për të vlerësuar rrezikshmërinë e mbetur. Po ashtu, ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese nuk ka dhënë konstatim se është arritur risocializimi, andaj marr parasysht faktin se risocializimi është një proces që siguron se i dënuari është i gatshëm që të riintegrohet në shoqëri pa rrezik për t'u kthyer në veprime të paligjshme dhe mungesa e një konstatimi të tillë nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese tregon se procesi i risocializimit nuk ka përfunduar.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj, dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Panelit për Lirim me Kusht, të precizuara në tërësi si në këtë vendim. Refuzimi i kërkesës për lirim me kusht të ushtruar i dënuari, është i mbështetur në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe në Rregulloren nr. 01/39, duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitat ligjore nga ligjet e sipërcituar, dhe nga rregullorja nr. 01/39 nr.01/39, mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht, dhe kushtet që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, andaj në rastin konkret Paneli me rastin e vendosjes mori parasysht edhe nenin 14 par. 1 pikën 1.1 të Rregullores nr. 01/39, ngase pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 3 (tre) muaj, andaj e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se, Paneli ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në lirim me kusht të personit të dënuar që parashihen në nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht. Rrethanat përfshijnë: përkrahimin e personit të dënuar për veprën penale, gjendjen fizike dhe psikike të tij, qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës,

sjelljen e mirë gjatë burgimit, përkatësisht të dhënat nëse është shqiptuar masë disiplinore ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit, rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore, dhe pastaj Paneli ka konstatuar se kërkesa duhet refuzuar me të drejtë rishqyrtimi për 3 muaj.

Përfundimisht Gjykata Suprem e Kosovës duke i respektuar kufijtë e ekzaminimit të ankesës dhe kompetencën e shqyrtimit, gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk gjeti se është zbatuar gabimisht ligji material, nuk janë shkelur rregullat e procedurës së paraparën për shqyrtimin e kërkesës dhe nuk ka ndo një gabim faktik lidhur me rastin konkret, prandaj edhe refuzoi si të pa bazuar ankesën e të dënuarit.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

A.A.nr. 45/2024, më 02.12.2024

Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami